



TE DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

Emri i NSH-së	NSH “Fan Zahir Pajaziti”, (“Ndërmarrja”)
Emri i Ndërmarrjes së Re	Ndërmarrja e Re Hotel FAN Besiana SH.P.K., (“Ndërmarrja Subsidiare”)
Vendndodhja	Ndërmarrja e Re Hotel FAN Besiana SH.P.K. gjendet në qytetin e Podujevës në pjesën veri-lindore të Kosovës, 30 km larg Prishtinës në kryqëzimin e Rrugës Prishtinë – Merdare dhe Rrugës Zahir Pajaziti.
Biznesi/Spektori	Ofrimi i të gjitha shërbimeve për hoteleri dhe rekreacion.
Prodhimet	J/A
Tregu	Ndër. Re e propozuar, ka një kapacitet shumë të mirë komercial, falë vendndodhjes së tokës dhe objektit / lokaleve që do të transferohen, gjithashtu moteli ka një përvojë shumëvjeçare me reputacion të mirë në regionin e Podujevës.
Konkurrenca	Industria për hoteleri, rekreacion dhe turizëm është njëra ndër sektorët më së shpejti të zhvilluar në Kosovë.
Punonjësit	Nuk ka punëtorë që do të transferohen në Ndërmarrjen e Re.
Ndërtesat dhe tokat	Ndërmarrja e Re Hotel FAN Besiana SH.P.K. përfshinë tokën me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 10,148 m ² (1 ha 1 ari 48 m ²) dhe ndërtesën pesëkatëshe që shtrihet mbi këtë tokë me sipërfaqe totale të përafërt prej rreth 3,036 m ² , që gjenden në qytetin e Podujevës në pjesën veri-lindore të Kosovës, 30 km larg Prishtinës në kryqëzimin e rrugës Prishtinë – Merdare dhe rrugës Zahir Pajaziti. Prona e propozuar është e regjistruar në dokumentet kadastrale në emër të Ndërmarrjes me Certificate nr. UL-71712062-01660, Zona Kadastrale Podujevë.
Detyrimet që do të barten:	(1) Detyrimet neto të NSH-së për TVSh, ku përjashtohen kamatat dhe gjokat, të cilat janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri; (2) Detyrimet e papaguara të NSH-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri; (3) Detyrimet e NSH-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

apo në emër të punonjësve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë shfaqur gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;

- (4) Kosto e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve (duke mos i përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera për ose në emër të punëtorëve të NSh-se në kapacitetin e tyre si punëtorë) e mbledhur gjatë rrjedhës normale të biznesit që:
- a) Është mbledhur gjatë periudhës tre mujore që përfundon në datën kur deklarata relevante e transferit ka hyrë në fuqi;
 - b) Që mbetet e papaguar deri në atë datë dhe i ngarkohet biznesit të NSh-se.

**Shikim parcial i
Ndër. Re**



Informata

Departamenti për Shitje
Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)
Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1255
Fax: +381 (0) 38 248 076
www.pak-ks.org

**Dokumentet për
Ofertë**

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)
Rruga Ilir Konushevcit Nr. 8
10000 Prishtinë/Pristina, Kosovo

Informatat rreth Ndërmarrjes së Re të prezentuar në këtë Të Dhëna nuk janë të përligjura. Investitorët potencialë inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilët dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në humnjet e tyre. Investitorët potencialë këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme të informata paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: